

VENDIM
Nr. 561, datë 29.9.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 712, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURRIMIT PUBLIK PËR TË DREJTËN E PESHKIMIT NË UJËRAT E BRENDSHME, FORMAT E TJERA TË PESHKIMIT NË DET, PA PËRDORIMIN E MJETEVE LUNDRUESE, DHE PËR ZHVILLIMIN E AKUAKULTURËS NË SIPËRFAQE PUBLIKE, TOKËSORE DHE UJORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 52, pika 3, e 30, pika 7, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", dhe të nenit 17, të ligjit nr. 103/2016, "Për akuakulturën", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 712, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në shkronjën "a", të pikës 4, fjala "aplikim" zëvendësohet me fjalën "kërkesë".
2. Në pikën 5, emërtesa "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR)" zëvendësohet me "Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB)".

3. Pas pikës 12/1 shtohet pika 12/2, me këtë përmbajtje:

"12/2. Njoftimi për botim për konkurrim publik, për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme, format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve të tjera lundruese dhe për zhvillimin e aktivitetit të akuakulturës në sipërfaqe publike, tokësore dhe ujore, shpallet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe përmban të dhënat për zonën ujore, pikët vlerësuese për elementet e konkurrit, dokumentacionin (plan-biznesin tip) që paraqesin konkurrentët në portalin *e-Albania*, datën dhe orën e paraqitjes së dokumentacionit. Data e konkurrit të jetë jo më parë se 7 (shtatë) ditë kalendarike nga data e botimit."

4. Në pikën 14 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

- a) shkronja "e" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"e) merr vendim për çdo subjekt që paraqet kërkesë, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga paraqitja e tyre, duke ua njoftuar vendimin të gjithë kërkuuesve, sipas adresës përkatëse;"

- b) pas shkronjës "e" shtohet shkronja "P", me këtë përmbajtje:

"f) dërgon njoftimin e fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga përfundimi i afatit të ankesave, në rastin kur nuk është paraqitur asnjë ankesë, ose brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga marrja e vendimit për ankesat e paraqitura."

5. Pas pikës 17 shtohen pikat 17/1 dhe 17/2, me këtë përmbajtje:

"17/1. Ministri, me urdhër, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga paraqitja e ankesës, përcakton komisionin e shqyrtimit të ankesave, me 3 (tre) anëtarë, me përbërje:

- një specialist i fushës;
- një ekonomist; dhe
- një jurist.

Komisioni shqyrton ankimet dhe paraqet te ministri një raport, ku pasqyrohen ankesat, rrethanat e faktit dhe arsyetimi për çdo ankesë të paraqitur. Kur komisioni vlerëson se në procedurën konkurruese janë shkelur kriteret procedurale apo ka pasur parregullsi në kryerjen e vlerësimit të kërkesave, atëherë ai i propozon ministrit anulimin e procedurës së zhvilluar ose rivlerësimin nga komisioni i vlerësimit të kërkesave, të kërkesave të paraqitura. Kur komisioni vlerëson se në procedurën konkurruese nuk janë shkelur kriteret procedurale apo nuk ka pasur parregullsi në kryerjen e vlerësimit të kërkesave, atëherë ai i propozon ministrit vazhdimin e

mëtejshëm të procedurës dhe njoftimin e palës ankimuese. Për çdo ankesë merret një vendim i veçantë.

17/2. Shqyrtimi i ankesës përfundon brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e paraqitjes. Komisioni merr në shqyrtim njëkohësisht të gjitha ankesat, në rast se ka më shumë se një ankesë, për të njëjtën procedurë konkurrimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama